



DPPS BNJ

BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
KRYETARI

V E N D I M

Nr. 9229, datë 09.3.2020

P Ë R

MIRATIMIN E PLANIT STRATEGJIK TË BASHKISË TIRANË PËR VITIN 2020

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 64, shkronjat "a" dhe "b", të ligjit 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, vendimit nr. 160, datë 21.12.2018, të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Qendrueshëm të Bashkisë Tiranë 2018–2022", vendimit nr. 48492 prot., datë 20.12.2019, të Kryetarit të Bashkisë "Rregullore për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së Bashkisë së Tiranës", si dhe në vijim të Memos me nr. 9229 prot., datë 28.2.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit Strategjik dhe Burimeve Njerëzore drejtuar Kryetarit të Bashkisë, me lëndë "Miratimin e Planit Strategjik të Bashkisë Tiranë për vitin 2020",

V E N D O S:

1. Miratimin e Planit Strategjik të Bashkisë Tiranë për vitin 2020, sipas materialit bashkëlidhur pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohen Drejtoritë e Përgjithshme të aparatit të Bashkisë Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Erion VELIAJ





PLANI STRATEGJIK BASHKIA TIRANË Viti 2020

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK DHE
BURIMEVE NJERËZORE

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Misioni i Bashkisë Tiranë është sigurimi i një qeverisje të drejtë, të efektshme dhe efikase me qytetarët duke njohur dhe respektuar ekzistencën e identiteteve dhe vlerave të ndryshme të komunitetit, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të tyre, duke mbështetur dhe siguruar mirëqënie dhe duke garantuar standarde bashkëkohore në ofrimin e shërbimeve, mjedis të shëndetshëm, vlera të larta të bashkëjetesës komunitare dhe një ndjenjë të pronësisë/zotërimit mes banorëve mbi të mirat publike.

Për të përmbushur këtë mision Bashkia e Tiranës, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik dhe Burimeve Njerëzore, ka hartuar Planin Strategjik të Bashkisë Tiranë për vitin 2020 (PSBT), një dokument që përmban prioritetet dhe objektivat e institucionit, të detajuara dhe grupuara sipas 11 Drejtorive të Përgjithshme. Për çdo Drejtori të përgjithshme janë përcaktuar objektivat dhe projektete apo aktivitet që do të zhvillohen nga drejtoritë e të gjithë aparatit të BT-së. Bazuar tek funksionet që ka çdo drejtori janë përcaktuar strukturat përgjegjëse dhe strukturat mbështetëse për realizimin e këtij plani.

PSBT 2020 përcakton në mënyrë të detajuar të gjitha veprimet të cilat duhet të ndërmerren për t'i arritur objektivat dhe prioritetet strategjike. PSBT është përpiluar në bazë të: (i) Funksioneve, kompetencat dhe detyrat e përcaktuara nga kuadri ligjor dhe rregullorja e BT-së, (ii) Prioritetet dhe objektivat e përcaktuara nga Strategjia e Zhvillimit të Qendrushëm të Bashkisë Tiranë 2018 – 2022, (iii) Platformën socio-ekonomike të Kryetarit të Bashkisë, (iv) Buxhetin e miratuar në Këshill Bashkiak viti 2020 dhe (v) Planet vjetore të strukturave të BT-së.

Në këtë dokument janë specifikuar prioritetet e vitit 2020, të detajuara në objektiva, programe, projekte/aktivitete dhe në indikatorë të monitorueshëm për të gjitha drejtoritë e BT-së. Në disa raste ka më shumë se një strukturë përgjegjëse, kjo nisur nga kompleksiteti që kanë disa projekte. Jo të gjitha drejtoritë e aparatit qendror kanë ndikim /përgjegjësi direkte në realizimin e objektivave të institucionit, pasi disa prej tyre kanë funksion asistencë/mbështetje në mbarvajtjen e punës dhe situata tilla nuk janë përfshirë në këtë dokument.

Hartimi dhe zbatimi i këtij plani do të kontribuojë jo vetëm në përmbushjen e prioritetëve dhe objektivave që ka Bashkia e Tiranës për vitin 2020, por do lehtësojë koordinimin mes strukturave si edhe do të përmirësojë ndjeshëm procesin e transparencës me qytetarët të cilët janë edhe përfituesit e drejtpërdrejtë nga përmbushja e objektivave.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË BASHKISË TIRANË PËR VITIN 2020

I. Përmirësimi i infrastrukturës arsimore dhe rritja e aksesit dhe gjithpërfshirjes në arsim

Vizioni i BT-së në drejtim të sektorit të arsimit synon ofrimin e një infrastrukture moderne të institucioneve arsimore, që bazohet në plotësimin e nevojave dhe interesave të nxënësve dhe studentëve në Tiranë, për të garantuar rritjen e cilësisë së mësimdhënies, sigurimine standardeve dhe aksesit më të lartë nga të gjithë grupet shoqërore në të gjithë territorin, standarde në rezidencat universitare si dhe kthimin e institucioneve arsimore në qendra të rëndësishme komunitare.

Përmirësimi i cilësisë së infrastrukturës arsimore si dhe krijimi i infrastrukturave të reja do të vazhdojë të jetë një objektiv strategjik edhe për vitin 2020. Gjithashtu BT i ka dhënë prioritet më shumë se kurrë rritjes së aksesueshmërisë arsimore për grupet e pa favorizuara si fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët në zona të thella rurale dhe ata me ndihmë ekonomike duke iu përmbajtur vizionit të saj dhe atij kombëtar.

Rezidencat universitare do të vazhdojnë të jenë në fokus të punës së BT edhe për këtë vit duke qenë se Tirana akomodon numrin më të lartë të studentëve në të gjithë Shqipërinë, kjo jo vetëm për faktin se në kryeqytete janë përqendruar numri më i madh i institucioneve të arsimit të lartë por sepse metropoli ofron më shumë mundësi për punësim.

BT synon të nxisë shfrytëzimin maksimal të hapësirave të këtyre objekteve në funksion të edukimit dhe ndërveprimit të komunitetit nëpërmjet programit “Shkolla si Qendra Komunitare”.

II. Qytet i aksesueshëm dhe gjithpërfshirës

PSBT për vitin 2020 e vë theksin në zhvillimin e një qyteti gjithëpërfshirës, i cili është në funksion të qytetarëve dhe garanton një zhvillim të integruar ekonomik, social dhe territorial duke rritur mirëqënien e qytetit.

Tirana për të gjithë përbëhet nga një grup politikash me fokus rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe rritjen e aksesueshmërisë së qytetit nga të gjithë. Nëpërmjet këtij objekti, synohet përmirësimi i një sërë elementesh me impakt të drejtpërdrejtë tek çdo grupmoshë e popullsisë që përfshihen në territorin e BT-së.

Ky objektivi është një ndër më sfidueset dhe synon të nxisë mobilitetin alternativ nëpërmjet zgjerimit të rrjetit të korsive të dedikuara për biçikleta dhe përmirësimin të shërbimit të operatorëve në këtë fushë, të përmirësojë situatën e parkimit nëpërmjet rritjes së kapacitetit dhe përdorimin efiçent të hapësirave ekzistuese dhe përmirësimin të shërbimit të parkimit me pagesë. Vëmendje ka edhe transporti publik ku do të garantohet një sistem transporti i sigurt, miqësor ndaj mjedisit dhe me eficiencë të lartë për distanca mbi 5 km.

Hapësirat publike të gjelbra do vazhdojnë të jenë nën një proces transformimi të qëndrueshëm me qëllim shtimin e sipërfaqeve që i japin frymëmarrje qytetit. Vëmendje edhe për këtë vit do të kenë rehabilitimet e blloqeve të banimit si dhe nxitja e bashkëpunimit efektiv mes BT-së dhe qytetarëve për përmirësimin e infrastrukturës së objekteve në bashkëpronësi.

Përpjekjet e BT-së për të siguruar një qytet të pastër, me një sistem të mirë të manaxhimit të mbetjeve dhe të furnizimit të ujë do të vazhdojnë dhe zbatimi i projekteve të planifikuara do të japë efektet e pritshme për të gjithë qytetarët.

III. Rivitalizim urban që harmonizon infrastrukturën, shërbimet publike dhe nxit zhvillimin ekonomik

Me reformën administrative territoriale BT tashmë përfshin një territor me një sipërfaqe rreth 25 herë më të madh dhe heterogjen. Kjo ka nxitur projektimin e një sistemi policentrik që bazohet jo vetëm në praninë e disa epiqendrave urbane, me orientim ekonomik dhe shoqëror por edhe me ndërveprim dhe ndërvarësi që lindin prej tyre.

Dinamikat policentrike të ardhshme janë përcaktuar duke marrë në konsideratë praninë e sektorëve të rëndësishëm të ekonomisë, karakteristikat e veçanta shoqërore dhe sociale dhe profilet aktuale të zhvillimit. Krahas funksioneve kryesore për çdo pol është parashikuar përmirësimi i shërbimeve bazike shkolla, çerdhe, kopshte, infrastrukturë rrugore, parqe, qendra komunitare dhe kulturore, etj. Për secilin pol është parashikuar një kuotë ndërtimi në konvencion apo

subvencion me shërbimet kryesore në mënyrë që të kthehen në zona të pëlqyeshme në çdo orë të ditës. Projektet që parashikohen të zbatohen për krijimin dhe funksionimin e pesë poleve urbane, gjatë vitit 2020 do të realizohen në tre shkallë:

Policentrizëm në shkallë urban. Në këtë fazë në vëmendje do të jenë rehabilitimi dhe mobilimi urban që përfshin infrastrukturën e rrjeteve inxhinjrike, rrjetit rrugor, hapësirave publike, sipërfaqeve të gjelbra, ndriçim etj

Policentrizëm në shkallë lokale. Fokusi në këtë fazë do të jetë mbi furnizimin me shërbime publike i epiqendrave dhe zonave përreth. Këtu përfshihen ndërtim/rehabilitim i shkollave, çerdheve dhe kopshteve, tregjeve publike, qendrave sociale, kënde lojrash, terrene sportive etj

Policentrizëm në shkallë territoriale. Në këtë fazë do themelohen institucione/partneritet me komunitetin apo aktorë të tjerë të përfshirë që do të krijojnë tipare të dallueshme sipas karakterit të çdo poli.

IV. Garantimi i zhvillimit të qendrueshëm ekonomik

Ekonomia e Tiranës në përgjithësi ka qenë dhe vazhdon të jetë e ushqyer nga sektorët e shërbimeve, tregtisë, ndërtimit dhe transportit. Si sektorët me prurjet më të mëdha të të ardhurave gëzojnë vëmendjen më të madhe dhe të vazhdueshme si nga pushteti vendor edhe nga ai qendror. Por tashmë, sipërfaqja e shumëfishuar e BT-së me 13 NJA-të rurale dhe kompetencat e reja që i kanë kaluar BT-së, evidentojnë nevojën për ti kushtuar vëmendje më të lartë zhvillimit të qendrueshëm të ekonomisë.

Qëllimi është të krijohen modele të qëndrueshme në tre aspektet/kolonat e veprimtarisë njerëzore: ekonomike, sociale dhe ekologjike. Zhvillimit i qendrueshëm i ekonomisë nënkupton gjetjen e një ekuilibri koherent dhe një harmonie afatgjatë në mes të këtyre tre kolonave. Kjo çështje ndërsektoriale do të jetë sfida edhe për vitin 2020 për BT, që duhet të marrë në konsideratë këto aspekte në përcaktimin dhe zbatimin e politikave dhe duhet të përfshijë domosdoshmërisht pjesëmarrjen e vazhdueshme të të gjitha palëve të interesuara (qytetarët, bizneset, shoqatat,

etj) si formë e suksesshme e demokracisë pjesëmarrëse.

Duke qenë se zhvillimi i ekonomisë është një proces transformimi në të cilin shfrytëzimi i burimeve natyrore, përzgjedhja e investimeve, orientimi i ndryshimeve teknologjike dhe institucionale realizohen duke garantuar qendrueshmëri në të ardhmen, janë parashikuar programe e projete që synojnë përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe pajisja me infrastrukturën e nevojshme për bizneset, mbështetje financiare dhe incentiva fiskale, ritja e konkurrueshmërisë dhe thithja e investimeve të huaja.

V. Forcimi i qeverisjes së mirë dhe respektimi i të drejtave të qytetarëve

Qeverisja e mirë përbën ndër kushtet thelbësore që duhet të plotësojë një shtet demokratik dhe sidomos aspirues për tu integruar në BE. Qeverisja e mire fillon në nivel vendor dhe të njëjtat parime të qeverisjes së mirë, aplikohen edhe në nivel qendror. Këto parime janë shprehur qartë në Kartën Europiane të vetëqeverisjes vendore, të cilën Shqipëria është angazhuar ta zbatojë. Bazuar edhe tek parimi i subsidiariteti, përgjegjësitë publike duhet të ushtrohen nga autoritetet të cilat janë më pranë qytetarëve. Autoritetet e QV-ve janë në pozicionin më të mirë dhe më të informuar për të ndërmarrë veprime të suksesshme në nivel vendor dhe rajonal. Kjo nënkupton jo vetëm pushtet vendor por edhe përgjegjësi vendore. BT ka përcaktuar si prioritet të saj forcimin e qeverisjes së mirë dhe respektimin e të drejtave të qytetarëve i cili do të realizohet nëpërmjet 3 programeve:

Rritja dhe forcimi i kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore në nivel vendor ka për qëllim funksionimin me eficiencë të lartë të sistemit të zhvillimit të kapaciteteve dhe burimeve njerezore të administratës së BT-së në koordinim me planet dhe objektivat strategjike të institucionit me synimin e vetëm, përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike.

Sigurimi i një qeverisjeje transparente dhe rritja e llogaridhënies ka për qëllim garantimin e njëqeverisje të mirë të orientuar drejt qytetarëve. Vendimarrja vendore do të jetë gjithpëfshirëse dhe transparente dhe me pjesëmarrje të balancuar gjinore. Llogaridhënia në nivel vendor do të nxitet edhe nëpërmjet zbatimit të sistemeve të menaxhimit të performancës, që do të jenë instrumente objektive në transparencën dhe llogaridhënien e njësive të qeverisjes vendore.

Forcimi i financave vendore që ka për qëllim garantimin e një menaxhimi financiar të shëndoshë në BT. Praktikrat më të mira të menaxhimit financiar në nivelin do të shoqërohen me rritjen e llogaridhënies dhe kontrollin financiar për të shmangurabuzimet dhe korrupsionin në nivel vendor.

Për këtë objektiv në bashkëpunim me të gjitha strukturat e BT-së janë përcaktuar 3 programet dhe 7 aktivitetet/projektet të cilat do të bëjnë të mundur përmbushjen e këtij objekti. Në këtë plan janë përcaktuar gjithashtu edhe indikatorët të cilët do të përdoren për procesin e monitorimit dhe vlerësimit të përmbushjes së objektivit.


STRUKTURA E BT-së DHE PLANET E DREJTORIVE TË PËRGJITHSHME

Bashkia e Tiranës është e organizuar në 11 Drejtori të përgjithshme në varësi të plotë nga Kryetari dhe nga 49 drejtori, kjo bazuar në Urdhërin e Kryetarit nr. prot. 1108, datë 10.01.2019 Për “Miratimin e Strukturës dhe Organikës të Institucionit të Bashkisë së Tiranës”.

Bazuar në Rregulloren për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Tiranë, është krijuar një kuadër rregullator për funksionimin me efikasitet dhe eficiencë të administratës ku secila prej këtyre strukturave e ka të mirëpërcaktuar misionin dhe detyrat që duhet të realizojë. Detyrat rutinore administrative nuk janë përfshirë në PPBT pasi pavarësisht objektivave të cilat ndryshojnë nga viti në vit, këto detyra mbeten të njëjtat.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj administrata e BT-së bazohet në këto parime:

- ◆ parimi i barazisë
- ◆ parimi i ligjshmërisë
- ◆ parimi i ndalimit të konfliktit të interesit
- ◆ parimi i mbrojtjes së interesit publik
- ◆ parimi i vazhdimësisë
- ◆ parimi i transparencës
- ◆ parimi i ndershmërisë
- ◆ parimi i bashkëpunimit



PLANI DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË OBJKETEVE NË BASHKËPRONËSI, ADMINISTRIMIT TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE DHE EMERGJENCAVE CIVILE (DPOBANJAEC) 2020

Misioni:

DPOBANJAEC është përgjegjese për administrimin e çdo çështje që lidhet me sigurimin e ofrimit të shërbimeve në fushën e bashkëpronësisë dhe koordinimit me 24 Njësitë Administrative dhe 3 Lagjeve si dhe për mirëadministrimin e çdo çështje që lidhet me menaxhimin e rasteve të emergjencave civile duke marrë masat e duhura parandaluese dhe masa konkrete për minimizimin e pasojave.

OBJEKTIVAT	PROJEKTE / AKTIVITETE		DREJTORIA PËRGJEGJËSE	INDIKATORËT
Hartimin e politikave për implementimin e projektit për Administrimin e Bashkëpronësisë.	1.1	Regjistrimi dhe formalizimi i strukturave të Kryesive	Drejtoria e Objekteve ne Bashkepronesi dhe Administrimit te NjA	Numri i kryesive të regjistruara.
	1.2	Regjistrimi dhe formalizimi i Administratorëve		Numri i administratorëve të formalizuar.
	1.3	Regjistrimi dhe formalizimi i kontratave mes kryesive dhe administratorëve		Numri i kontratave
	1.4	Digjitalizimi ne sistemin Online për të gjitha objektet e banimit		Sistem online funksional
	1.5	inspektimi i veprimtarise se administratoreve		Numri i inspektimeve
	1.6	Përcaktimi i standardeve minimale për ruajtjen e higjienës, shëndetit publik, mbrojtjen kundër zjarrit si dhe mirëmbajtjen fizike të mjediseve që janë pjesë e aktit të bashkëpronësisë		Rregullore e hartuar dhe e miratuar
Programi "Fondi i Komuniteteve"	2.1	Bashkëpunim me të gjithë kryesitë dhe administratorët e certifikuar për të nxitur bashkëpunimin dhe hartimin dhe zbatimin e projekteve		Numri i projekteve të miratuar
implementimi i listës së shërbimeve që u jepen qytetarëve në Njësitë Administrative, sipas urdhrin të Kryetarit të Bashkisë, Nr. 29662, datë 05.10.2016	3.1	Trajnim me stafin e Njësisve Administrative		Numri i trajnimeve te realizuara
Unifikim i procedurave dhe akteve shkresore. Rritje të performancës së personelit në Njësi Administrative dhe Lagje	4.1	Njohje dhe zbatim i përpiktë i Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë, Nr. Prot 2580, datë 18.01.2018, "Për Njësimin e dokumentave zyrtare"		Unifikimi i shkresave te te gjithe Njesive dhe Lagjeve
	4.2	Përdorimin e plotë dhe vetëm të emailit zyrtar për komunikimin në punë.		Unifikim i komunikimit elektronik permes cloud.tirana.al
	4.3	Trajnim me stafin e Njësisve Administrative	Numri i trajnimeve te realizuara	
Organizimi i konsultimeve publike për buxhetimin me pjesëmarrje.	5.1	Marrja e masave për organizimin dhe njoftimin në kohë të konsultimeve	Numri i konsultimeve dhe numri i pjesemarrsesve	
Organizimi i konsultimeve publike me kërkesë të qytetarëve dhe shoqërisë civile	6.1	Marrja e masave për organizimin dhe njoftimin në kohë të konsultimeve	Numri i konsultimeve dhe numri i pjesemarrsesve	
Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i Bashkisë Tiranë dhe Njësisve në rang ndërinstytucional.	7.1	Njohja e plotë e organizimit të Bashkisë Tiranë dhe përfaqësim në mbrojtje të interesave dhe qëllimeve të Bashkisë Tiranë.	Numri i aktiviteteve	

Marrja e masave për parandalimin, mbrojtjen dhe përgjigjen ndaj situatave emergjente që mund të krijohen nga fatkeqësi natyrore ose nga dora e njeriut, në territorin që administrojnë Bashkia Tiranë.	8.1	Plan – Veprimi për përballimin e emergjencave civile që mund të evidentohen në territorin që përfshin Bashkia Tiranë dhe planeve të gatishmërisë.	Drejtoria e Emergjencave Civile	Dokument kryesor i hartuar dhe miratuar.
	8.2	Përditësimi i sistemit të lajmerimit të Bashkisë Tiranë, Njësive Administrative, dhe institucioneve të varësisë		Sistem funksional
	8.3	Ngritja e strukturave të përhershme ose të përkohshme, grupet e verifikimit në terren të demeve në rastet emergjente.		Numri i strukturave/grupeve të krijuara
	8.4	Evidentimi dhe përcaktimi i të gjitha zonave me rrezik në territorin që përfshin Bashkia Tiranë.		Koordinatat në hartë.
	8.5	Kapacitetet në burime njerëzore e logjistike dhe gjendjes aktuale të vendeve për evakuimin e popullatës në rast emergjence.		Numri dhe vendodhja e ambjenteve në dispozicion dhe nr. i grupeve operative.
Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe rehabilitimi për të arritur aftësinë ripërtëritëse me qëllim zvogëlimin e riskut të fatkeqësive në të ardhmen.	9.1	Trajtimi me ndihmë financiare të banorëve të prekur nga fatkeqësi natyrore për mbulimin e dëmeve.		Vlera financiare e dëmit. Dhe numri i banorëve të demshperblyer
	9.2	Kryerja e ekspertizave teknike dhe rinovimi i marrëveshjes me institutin e Ndërtimit me qëllim përcaktimin e saktë të shkaqeve të dëmit.		Numri i ekspertizave teknike të kryera dhe marrëveshje të rinovuar
	9.3	Marrëveshja për lejet e ndërtimit me institutin e Ndërtimit.		Numri i aplikimeve.
	9.4	Kryerja e investimeve sipas buxhetit të përcaktuar për vitin 2020.		Numri i projekteve.
	9.5	Takime dhe konsultime me specialistët e njësive administrative dhe grupe vullnetare.		Numri i takimeve
	9.6	Kryerja e manovrave stërvitore.	Numri i manovrave të kryera	
	9.7	Trajnime.	Numri i trajnimeve të realizuara	

PLANI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PROJEKTEVE STRATEGJIKE DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK (DPSPZHE) 2020

Misioni:

DPSPZHE është përgjegjëse për zbatimin e strategjive, politikave dhe planeve të fushës përkatëse në të gjithë territorin e Bashkisë, për të koordinuar procesin e brendshëm të raportimit lidhur me çështjet e integritimit Evropian dhe zbatimin të standarteve evropiane, për hartimin e programeve të posaçme të nxitjes së zhvillimit ekonomik urban dhe rural dhe ofrimit të informacionit dhe asistencës për bizneset dhe investitorët

OBJEKTIVAT	PROJEKTE / AKTIVITETE	DREJTORIA PËRGJEGJËSE	INDIKATORËT
Hartimi dhe zhvillimi i planeve dhe politikave në funksion të zhvillimit rural	1.1 Shërbim konsulence për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit për agregatorin bujqësor	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Rural	Hartimi i studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit
	1.2 Regjistri i fermerëve të Bashkisë Tiranë		Regjister funksional dhe numri i fermereve të regjistruar sipas NJA
	1.3 Ndjekja e PIZHR – 100 fshatrat		Perfitimet për 4 fshatrat në BT
	1.4 Projektit PEP-Njësia Administrative Baldushk		Numri i të punësuarve të gjeneruar
	1.5 Hartimi dhe zhvillimi i panairit “Shijo produktet lokale të Tiranës”		Numri i pjesëmarrësve në panair.
Hartimi i planeve dhe projekteve për mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve dhe kullotave në territorin e BT-së	2.1 Procesi i regjistrimit të fondit pyjor e kullosor në regjistrin e pasurive të paluajtshme pranë ASHK Tiranë.		Sipërfaqja e regjistruar m2
	2.2 Azhurnimi i kadastrës së fondit pyjor e kullosor & plani i mbarështimit të fondit pyjor dhe kullosor.		Sipërfaqja e azhurnuar m2
	2.3 Administrimi, zhvillimi, mbrojtja dhe shfrytëzimi i fondit të pyjeve publike.		Numri i kontratave të lidhura
	2.4 Miratimin e planit operacional, për parandalimin e shuarjes së zjarreve në pyje e kullota.		Numri i masave të marra.
	2.5 “Planet e mbarështimit të pyjeve e kullotave për ekonomitë pyjore “Pezë, Shesh, Krrabë-Gurrë” dhe “Fag”, Rove-Lunxh, Baldushk””		Hartimi dhe miratimi i planeve
	2.6 Planet e mbarështimit të pyjeve e kullotave për ekonomitë pyjore “Pezë”, “Shesh”, “Krrabë-Gurrë””		Hartimi dhe miratimi i planeve
Hartimin e planeve për mbrojtjen dhe menaxhimin e tokave bujqësore në pronësi publike dhe/ose private	3.1 Sipërfaqet e tokave bujqësore të pakultivuara		Sipërfaqja e tokës bujqësore e pakultivuar në m2
	3.2 Ofrimi i shërbimit këshillimor (Extensionit) për fermerët, që ndodhen brenda territorit të Bashkisë.		Nr. I fermerëve të këshilluar
	3.3 Sipërfaqet e tokave bujqësore të pandara për dhënien me qira		Sipërfaqja e tokës bujqësore të dhënë me qira

Teda Kashar	1.1	Pjesëmarrje aktive në Grupin Operacional (me pjesëmarrës nga të gjitha Ministritë e Linjës), që do të ngrihet nga AIDA për përgatitjen e të gjitha materialeve të nevojshme (projekte teknike, studime, plane etj.)	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Urban	Pjesëmarrja ne grupin operacional dhe përgatitja e materialeve te nevojshme
	1.2	Koordinimi I punës me struktura të tjera të BT për përgatitjen e të gjitha materialeve ndihmëse që do t'u ofrohet Grupit Operacional		Numri I strukturave te perfshira ne koordinim
	1.3	Përgatitja e dosjes përfundimtare e cila do të paraqitet në KIS		Dosje e përgatitur
	1.4	Përgatitja e termave të referencës për ofrimin e konsulencës që do ti ofrohet BT për përgatitjen e studimeve për TEDA kashar (në bazë të fondit të parashikuar në buxhetin e BT për vitin 2020		Terma reference te përgatitura
	1.5	Në rast të marrjes së statusit si projekt me potencial strategjik do të vijojë puna me aplkimin për marrjen e statusit si Investitor Strategjik të BT për projektin TEDA Kashar sipas kuadrit ligjor në fuqi		Marrje e statusit Investitor Strategjik
	1.6	Koordinimi I punës me kompaninë fituese dhe aktorë të tjerë që do të ofrojë konsulencë për përgatitjen e mëtejshme së paketës së plotë të dokumenteve që kërkohen		Plotesim I paketes se dokumentave
Krijimi i paketave promovuese (broshura, portale, manuale, studime etj) për ekonominë e Tiranës (Tirana Hub), dritarja Ekonomi dhe Biznes në webin e Bt-se.	2.1	Përditësimi I rubrikave të dritares ekonomike tashmë të krijuar në faqen elektronike të BT.		Numri I rubrikave te perdituesuara
	2.2	Plotësimi dhe hartimi I rubrikave të reja me qëllim krijimi e një kanali komunikimi mes investitorëve, sipërmarrësve dhe BT;		Numri I rubrikave te reja te krijuara
KET (Këshilli Ekonomik I Tiranës)	3.1	Përcaktimi I axhendës, vendit dhe pjesëmarrësve relaorë për takimin e radhës		Organizimi I mbledhjes se KET
	3.2	Njoftimi elektronik dhe telefonik I anëtarëve të KET		Numri I njoftimeve te derguara
	3.3	Organizimi logjistik I eventit		Numri I pjesemarrësve
Ngritje kapacitetesh sipas llojit të biznesit	4.1	Përcaktimi curriculës në varësi të individëve (startup, biznese, tregtarë etj.) që do të trajnohen		Numri I kurrikulave
	4.2	Organizimi logjistik I trajnimeve (vendi, trajnerë, relatues etj)		Numri I trajnimeve te realizuara
	4.3	Zhvillimi I trajnimeve		Numri I pjesemarrësve ne trajnime
Green Economy: Mbështetje financiare (Grant) për biznese të reja "të gjelbërta" të cilat bazohen në një model eko-miqësor, ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese "të gjelbërta", duke futur elementë go-green në to.	5.1	Hartimi i Projekt Propozimit dhe Udhëzuesit Operacional;		Projekt propozim dhe udhezues operacional I hartuar
	5.2	Hartimi i projekt vendimit për Këshillin Bashkiak të Tiranës dhe miratimi i tij;		Miratimi I projekt vendimit
	5.3	Përgatitja dhe përcjellja et dosjes së plotë për miratim në Komisionin e Ndihmës Shtetërore	Dosje e plote	
	5.4	Promovimi i projektit dhe fushatë informuese	Promovim I realizuar	
	5.5	Ngritja e organeve të projektit;	Struktura te krjuara	
	5.6	Aplikimi i pjesëmarrësve	Numri I aplikuesve	
	5.7	Verifikimi dhe vlerësimi i aplikuesve	Numri I fituesve	
	5.8	Monitorimi i projektit	Numri I aktiviteteve monitoruese	

Circular Economy: Workshop “Nxitja dhe Promovimi i ekonomisë qarkulluese”	6.1	Përgatitja logjistike e eventit (Vendi, pjesëmarrësit, relatorët) etj.	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Urban	Organizimi me sukses I aktivitetit
	6.2	Përgatitja e axhendës dhe njoftimi I pjesëmarrësve		Numri I pjesemarrësve
	6.3	Përgatitja e shkresave dhe njoftimi I strukturave përkatëse për prokurimin		Zhvillimi me sukses I aktivitetit
	6.4	Zhvillimi I eventeve		Numri I aktiviteve
Të ngrejme kapacitetet institucionale të Strukturave të zhvillimit ekonomik	7.1	Trajnime të vazhdueshme të organizuara nga ASPA		Numri I trajnimeve in house
	7.2	Trajnime të organizuara nga jashtë Bashkisë		Numri I trajnimeve jashte institucionit
Të ruajme parimet e eficensës, efikasitetit dhe ekonomisë në të gjitha detyrat e ngarkuara për realizim nga Drejtoria	8.1	Të monitorojmë projektet sipas fazave të ndryshme		Numri I projekteve te monitoruara
	8.2	Të menaxhojmë në bazë të rezultateve		Manaxhim I mire
	8.3	Të hartojmë analiza të sakta kosto – përfitim		Analiza te realizuara
Urdhërit të Kryetarit me Nr. 18468, datë 15.05.2017 “Për ngritjen e grupit të punës për dhënien e mendimit për kërkesat që parashtrihen pranë Bashkisë Tiranë për konfirmimin e përdorimit të objekteve shtetërore, të miratuara për privatizim nga institucionet administuese”	9.1	Verifikimin në terren të pasurive të parashtruara për mendim		Numri I pasurive te verifikuara
	9.2	Verifikimin e sipërfaqes dhe gjendjes fizike të këtyre objekteve		Rnumri raporteve te hartuara
	9.3	Hartimi i relacioneve shoqëruese dhe Memos informuese për Kryetarin e Bashkisë		Dokumentacion shoqerues I pergatitur
	9.4	Përgatitja dhe dërgimi i shkresës zyrtare për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave mbi konfirmimin ose jo të këtyre pasurive.		Numri I pasurive te konfirmuara
Hapja e Tregjeve të reja në Qytetin e Tiranës si një instrument zhvillimi ekonomik dhe social.	10.1	Hapja e një tregu të ri publik per Komunitetin ROM/Egjiptian		Numri I tregtareve te parashikuar
	10.2	Identifikimi I një hapsire të re për ndërtimin e tregut		Treg I ri hapur
	10.3	Koordinim me të gjithë aktorët e perfshire në proces		
	10.4	Draftimi I Akt-Marveshjes dhe miratimi I saj me VKB		
	10.5	Miratimi I projektit final me kostot		
11.1	Zbatimi I projektit licensimi I tregtareve të rinj ambulant ROM/Egjiptian	Pergatitje e dokumentacionit te nevojshem		
Zbatimi I Urdherit të Kryetarit për dhënien me qira të vendeve vakante për Markaten e Mbyllur Pazari I Ri.	11.2	Respektimi I procedures në përputhje me PSV e miratuar.	Numri I vendeve vakonate te shpalluara	
	11.3	Shpallja e vendeve vakante në përputhje me planimetrine përkatëse		
	11.4	Zbatimi I procesit të vlerësimit nga Komisioni I Vleresimit të Ofertave		Numri I ofertuesve

Ndërtimi I Tregjeve të reja në njësitë Administrative	12.1	Përgatitja e projektit teknik me preventivin (kostot financiare) dhe planin arkitektonik për hapsirën e përcaktuar në Njësinë Administrative Nr.7	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Urban	Projekt teknik I miratuar dhe plani arkitektonik
	12.2	Studim për nevoja tregjesh në 3 (tre) publike për Njësitë e Reja Administrative përkatësisht në:zonën Kashar;Zona Liqenit;dhe Fresku.Rishikimi i hapësirave të mundeshme në terren dhe verifikimi i statusit ligjor në koordinim me DPJAL për pronesine aktuale.		Studim I hartuar
	12.3	Bashkëpunim me Drejtorine e Projekteve Strategjike në përgatitjen e projektet teknike		Numri I tregtareve te licencuar
	12.4	Pergatitja e relacionit me VKB për tregjet e reja.		
	12.5	Licensimi I tregtarëve ambulant		
Hartim korrikulash për tregtarët ambulant kordinuar me TID TIRANA	13.1	Trajtim i tregtareve ambulant dhe informimi për paketen rregullatore në tregje		Numri I tregtareve ambulante te perfshire Numri I tregjeve ditore
	13.2	Koordinim me të gjithë aktoret e perfshire në proces		
	13.3	Hartimi I një plani-veprimi për tregjet e reja publike dhe trajnimi I tyre		
	13.4	Trajnim për Tregtarët ambulant të tregut Rom ne Shkozë.		
Ndërtimi i shesheve rekreative me kënde lojërash (organizimi dhe koordinimi i punës me drejtoritë e përfshira në këtë projekt (DPN1, DPN2, DPN3, APR, Drejtoria e Menaxhimit Financiar)	1.1	Përgatitja edhe dizenjimi I projektit të zbatimit për secilin shesh	Drejtoria e projekteve strategjike	Numri I shesheve rekreative të dizenuara.
	1.2	Përgatitja e dokumentacionit për miratim nga KT		Numri I shesheve rekreative të miratuara në KT.
	1.3	Ndjekja dhe mbikqyrja e zbatimit të projektit. Korrespondenca me drejtori apo institucione të ndryshme për realizimin e projektit.		Numri I shesheve rekreative të ndërtuar.
Ndërtimi i shesheve rekreative me kënde lojërash (organizimi dhe koordinimi i punës me drejtoritë e përfshira në këtë projekt (DPN1, DPN2, DPN3, APR, Drejtoria e Menaxhimit Financiar)	2.1	Përgatitja edhe dizenjimi I projektit të zbatimit për secilin shesh sportiv		Numri I shesheve sportive të dizenuara.
	2.2	Përgatitja e dokumentacionit për miratim nga KT		Numri I shesheve sportive të miratuara në KT.
	2.3	Ndjekja dhe mbikqyrja e zbatimit të projektit. Korrespondenca me drejtori apo institucione të ndryshme për realizimin e projektit.		Numri I shesheve sportive të ndërtuar.
Asistencë për përgatitjen e projekteve të ndryshme infrastrukturore për të gjitha NJA	3.1	Përgatitja edhe dizenjimi i projektit të zbatimit.		Numri I projektve te mbeshtetura nga DPS
Realizimi I Qendrës së Emergjencave Civile	4.1	Përgatitja edhe dizenjimi I projektit të zbatimit.		Realizimi I projektit
	4.2	Ndjekja dhe mbikqyrja e zbatimit të projektit. Korrespondenca me drejtori apo institucione të ndryshme për realizimin e projektit.		Aktivitete & korrespondenca të realizuara

Krijimi i "Metroboscos"	5.1	Ndjekja dhe mbikëqyrja e projektit të "Hartimi i PDV-ve që preken nga Metroboscos-Pyllit Orbital"	Drejtoria e Projekteve Strategjike	Aktivitete të realizuara
	5.2	Korrespondenca me drejtori apo institucione të ndryshme për realizimin e projektit.		Aktivitete të realizuara
Gjenerim Projekt-Idesh	5.1	Përgatitja e projekt-ideve në formën e materialeve grafike.		Numri i projektideve të iniciuara
	5.2	Korrespondenca me drejtori apo institucione të ndryshme për realizimin e projektit.		Aktivitete të realizuara
Përfitim i granteve të vogla dhe të mëdha nëpërmjet përfaqësive të Huaja të akredituara në Shqipëri dhe fondacioneve të ndryshme	9.11	Takime periodike me të gjitha përfaqësistë e huaja të akredituara në Tiranë me qëllim prezantimin dhe promovimin e projekteve të parashikuara nga Bashkia Tiranë për vitin 2019	Drejtoria e Integrimi evropian dhe projekteve te huaja	Numri i takimeve te realizuara Numri i perfaqwesive te huaja qe marrin pjese ne takime
Menaxhimi i njësisë së Integrit Evropian në Bashkinë e Tiranës	9.12	Menaxhimi dhe koordinimi i punës me strukturat përkatëse për mbështetjen e politikave të Integrit Evropian në nivel vendor.		Numri i strukturave te perfshira ne kete proces
Menaxhimi i Këndit të Informimit të BE në Bashkinë Tiranë	9.13	Menaxhimi i Këndit të informimit të BE-së dhe koordinimi me të gjithë aktorët institucional për zbatimin e politikave të intgrimit Evropian në nivel vendor.		Numri i vizitoreve ne Kendin e BE-se
Organizimi i aktivitete informuese dhe promovuese mbi programet dhe projektet e Bashkimit Evropian.	9.14	Organizimi i aktivitete informuese dhe promovuese me mbikëqyrjen dhe mbështetjen e strukturave të Koordinatorit Kombëtar të Instrumentit të Parazgjerimit (NIPAC);		Numri i aktiviteteve Numri i pjesemarrësve
Administrimi dhe publikimi i aktiviteteve të këndit të informimit në BE-sw	9.15	Administrimi dhe publikimi i informacionit lidhur me aktivitete e organizuara nga këndi i informimit të BE rreth dhe procesit të integrit evropian në nivel vendor; në faqen zyrtare të internetit të bashkisë dhe platforma të tjera komunikimi.		Numri i pjesemarrësve ne aktivitete
Plotësimi i Matricës së Integrit Evropian	9.16	Mbikëqyr dhe koordinon procesin e hartimit të raporteve të kërkuara nga Ministritë e linjës, lidhur me përmbushjen e kriterëve dhe të standardeve që rrjedhin nga procesi i integrit evropian dhe/ose zbatimit të asistencës së BE-së, për funksionet e veta apo të deleguara të bashkisë.		Numri i raporteve te hartuara

PLANI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PROMOVIMIT TË QYTETIT (DPPQ) 2020

Misioni:

DPPQ është është përgjegjëse për hartimin, programin dhe zhvillimin e politikave vendore dhe projekteve konkrete në funksion të ruajtjes, rijetëzimit dhe promovimit të trashigimisë kulturore dhe zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit në Tiranë për intesifikimin e jetës artistike e kulturore, rinore dhe mjedisore

OBJEKTIVAT	PROJEKTE / AKTIVITETE		DREJTORIA PËRGJEGJËSE	INDIKATORËT
Promovimi I vlerave kulturore dhe artistike të qytetit	1.1	Organizimi dhe mbështetja e aktiviteteve të ndryshme artistike dhe kulturore,	Drejtoria e Kultures dhe Trashegimise Kulturore	Numri I pjesëmarrësve
	1.2	Ekspozita artet figurative		Numri i pjesëmarrësve
	1.3	14 Mars Dita e Veres		Numri i pjesëmarrësve
	1.4	Tirana International Fanfara Festival		Numri i pjesëmarrësve
	1.5	Balkan JAZZ ShowCase		Numri i pjesëmarrësve
	1.6	Teatër		Numri i pjesëmarrësve
	1.7	Projektet kulturore të rëndësishme ndërkombëtare, koncerte, bienale (3 aktivitete)		Numri i pjesëmarrësve
	1.8	Projekte të dryshme artistike me impakt ndërkombëtar, festivale, konkurse, instalacione, arti i rrugës		Numri i pjesëmarrësve
	1.9	Projektet kulturore të rëndësishme ndërkombëtare, bienale		Numri i pjesëmarrësve
	1.1	Festival European i filmit		Numri i pjesëmarrësve
	1.11	1 Qershori- Festa e fëmijëve		Numri i pjesëmarrësve
	1.12	21 Qershori – Festa e Muzikës		Numri i pjesëmarrësve
	1.13	16 shtator- Festa e Pezes		Numri i pjesëmarrësve
	1.14	28 Nentori, Nata e bardhe		Numri i pjesëmarrësve
	1.15	Ndezja e dritave te festave 6 Dhjetor		Numri i pjesëmarrësve
	1.16	Festa e Krishtlindjeve		Numri i pjesëmarrësve
	1.17	Nata e Vitit të Ri		Numri i pjesëmarrësve

Promovimi i gjithë territorit të Bashkisë Tirane si destinacion turistik në tregun ndërkombëtar dhe nxitja e industrisë së turizmit në kryeqytet dhe rrethinat e tij.	2.1	Paketa Promocionale e Tiranës 2020	Drejtoria e Turizmit	Numri i paketave (harta/fletepalosje, broshura etj)
	2.2	Dita Ndërkombëtare e Guidave – 21 shkurt 2020		Numri i pjesëmarrësve
	2.3	Aktivitete në rrethina (ecje, vizite në punishte dhe agroturizem, etj)		Numri i pjesëmarrësve
	2.4	Festa e fërgesës- promovim i tradites se kulinarise		Numri i pjesëmarrësve
	2.5	Dita Boterore e Turizmit – 27 shtator (aktivitete)		Numri i pjesëmarrësve
Zhvillimi i politikave, projekteve dhe aktiviteteve për rritjen e edukimit dhe ndërgjegjësimin mjedisor të komunitetit	3.1	Aktivitete për promovimin e përdorimit të biçikletave në Tiranë, në periudhën Janar-Shkurt	Drejtoria e Politikave dhe Edukimit Mjedisor	Numri i pjesëmarrësve, numri i aktiviteteve të zhvilluara
	3.2	Aktivitet në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Tokës më 22 Prill		Numri i pjesëmarrësve
	3.3	Java e Mjedisit - Aktivitete në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Mjedisit, më datë 5 Qershor		Numri i pjesëmarrësve, numri i aktiviteteve të zhvilluara
	3.4	Java Europiane e Levizshmërisë – Aktivitete përgjatë gjithë javës 16-22 Shtator		Numri i pjesëmarrësve, numri i aktiviteteve të zhvilluara
	3.5	Fushata e mbjelljeve në Tiranë. Mbjellje e pemëve fidanëve dhe bimëve dekorative.		Numri i pemëve dhe fidanëve të mbjellë
Krijimi i një mjedisi multifunksional për të rinjtë e kryeqytetit duke synuar zgjidhjen e problematikave, nxitjen e pjesëmarrjes së tyre në vendimarrje, angazhimin social, promovimin e tyre në fushën artistiko-kulturor, edukues bazuar në zhvillimin e edukimit jo formal, jo vetëm në nivel lokal por dhe në atë europian.	4.1	Tirana Art Fest 5	Drejtoria e Rinisë	Numri i pjesëmarrësve
	4.2	“Public Speaking&Stand up comedy” 2		Numri i pjesëmarrësve
